

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "EOS ENERGY" Sh.p.k.

Sot, me datë 13/10/2022,

- **Z. Adrian Shehu**, shtetas shqiptar, lindur në Peshkopi, më 27.04.1988, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. Personal I80427005T, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "EOS ENERGY" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1
EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "EOS ENERGY" Sh.p.k.

NENI 2
SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Farkë e Vogël, Vila 5, Kati parë, Zona Kadastrale nr. 1605, Vol. 14, FQ 89.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvèç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4
OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Projektim, zbatim, ndertim te impjanteve te prodhimit te energjise me panele djellore;
- Shitia e energjise elektrike per kliente te ndryshem, shtet ose privat, te vendit ose te huaj;
- Shfrytezim dhe mirembajtje te pajisjeve te paneleve djellore;
- Projektim, ndertim dhe montim te pajisjeve dhe linjave te transmetimit te energjise elektrike;
- Punime te ndryshme ndertimore ne funksion te objekteve dhe pajisjeve te gjenerimit dhe transmetimit te energjise elektrike;
- Projektim dhe vleresim gjeologjik, ambiental dhe tekniko profesional ne per gjithësi;
- Projektim zbatim dhe ndertim i objekteve civile dhe industrial;



- Punime ndertimore te terreneve, kanalizimeve bonifikuese, te rrugeve dhe te tjera, pa cenuar objektin kryesor te shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 100,000 Lekë (njëqind mijë) dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Adrian Shehu**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100,000 (njëqind mijë) Lekë dhe 100,000 (njëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Z. Kujtim Prifti**, shtetas shqiptar, lindur më 28.07.1964, në Libofshë, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal G40728058R, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar ***Administratorin Z. Kujtim Prifti*** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES
ADRIAN SHEHU**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Adrian Shehu". It is written in a cursive style with a horizontal line underneath it.